

**VENDIM**  
**Nr.584, datë 27.7.2010**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR  
MINISTRINË E BRENDSHME, PRË DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE  
TË VIKTIMAVE DHE TË TË MBIJETUARVE TË AKSIDENTIT RRUGOR, TË DATËS  
17.7.2010, NË AKSIN RRËSHEN-FUSHË - ARRËZ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi i përgjithshëm 21 100 000 (njëzet e një milion e njëqind mijë) lekë, nga i cili:

a) 16 750 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, prefektit të qarkut të Shkodrës;

b) 4 350 000 (katër milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, prefektit të qarkut të Lezhës;

për t’u përdorur si ndihmë financiare për familjet e viktimave dhe të të mbijetuarve të aksidentit rrugor të datës 17.7.2010, në aksin rrugor Rrëshen-Fushë-Arrëz.

2. Shpërndarja e ndihmës financiare, sipas fondeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të kryhet, si më poshtë vijon:

a) Familjeve të viktimave t’u jepet shuma 1 000 000 (një milion) lekë, për çdo viktimë;

b) Familjeve të viktimave, t’u jepet shuma 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për përbalimin e shpenzimeve të ceremonive mortore, për çdo viktimë;

c) Çdo të mbijetuari t’i jepet shuma 300 000 (treqind mijë) lekë, për rehabilitimin shëndetësor.

3. Fondi i përgjithshëm 21 100 000 (njëzet e një milion e njëqind mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen prefektët e qarqeve të Shkodrës dhe të Lezhës që, në bazë të procedurave ligjore dhe të dokumenteve, përfshirë dokumentin e indentifikimit dhe dokumentet mjekësore, si dhe në bazë të dokumenteve të shpenzimeve të kryera për ceremonitë mortore, për çdo viktimë, t’u shpërndajnë përfaqësuesve të familjeve të viktimave e të të mbijetuarve shumat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 2 të vendimit, sipas listave me emrat e viktimave dhe me emrat e të mbijetuarve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe prefektët e qarqeve të Shkodrës e të Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lista me emrat e viktimave të aksidentit rrugor, në aksin Rrëshen-Fushë-Arrëz, më datë 17.7.2010

- 1.Adem Mustafa, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër
- 2.Lavdie Mustafa, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër
- 3.Edona Adem Mustafa, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër
- 4.Arsen Gjon Marku, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 5.Alma Nikoll Marku, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 6.Zef Gjegj Marku, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 7.Paulin Lazër Gjoni, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 8.Fran Llesh Paluku, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 9.Gjovalin Gjini Peraj, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 10.Marie Prenga, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 11.Adela Paulin Prenga, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 12.Marie Ndue Lleshi, Bashkia Mamurras, Qarku Lezhë
- 13.Mimoza Mëhill Dyzeni, Bashkia Laç, Qarku Lezhë
- 14.Preng Gjon Dyzeni, Bashkia Laç, Qarku Lezhë

Lista me emrat e të mbijetuarve të aksidentit rrugor, në aksin Rrëshen-Fushë-Arrëz, më datë 17.7.2010

- 1.Mirsad Adem Mustafa, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër
- 2.Armando Adem Mustafa, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër
- 3.Arnisa Adem Mustafa, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër
- 4.Marlinda Adem Mustafa, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër
- 5.Gjon Ded Marku, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 6.Albiona Gjon Marku, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 7.Flora Ndue Peraj, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 8.Erikson Gjini Peraj, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 9.Gentian Neçi, Komuna Gjegjan, Qarku Shkodër
- 10.Desara Preng Dyzeni, Bashkia Laç, Qarku Lezhë
- 11.Ilir Prendi, Bashkia Mamurras, Qarku Lezhë